

MARRËVESHJA PËR INTEGRIM

Çfarë është marrëveshja për integrim?

Është dokumenti që qytetari i huaj (nga moshë 16 vjeç) firmos në Prefekturë ose Kuesturë kur hyn për herë të parë në Itali, në momentin e kërimit të lejes së qëndrimit me vlefshmëri të paktën një vit. Akordi ka si qëllim lehtësimin e integrimit të qytetarit të huaj, parashikon përmbushjen e parimeve themelore të Kushtetutës Italiane dhe studimin e gjuhës italiane.

Prefektura do të verifikojë kredit e maturuara në dy vitet e para për personat që hyjnë në Itali për motive:

- Pune
- Studimi
- Rezidenca elektive (raste të veçanta rezidenze)
- Motive fetare

Për informacione të mëtejshme

www.immigrazione.regione.toscana.it > Area tematica > Accordo di integrazione (Akori i integrimit)

TEST I GJUHËS ITALIANE

Kush duhet të bëjë testin e gjuhës italiane?

Kush zotëron një leje qëndrimi për të paktën 5 vjet dhe dëshiron të kërkojë lëshimin e një leje qëndrimi afatgjatë KE

Kush nuk duhet të bëjë testin?

Të miturit në moshë 14 vjeç; personat me kufizime të rënda në kapacitetin e mësimin të gjuhës që lind nga sëmundja, moshë ose paaftësi totale; kush ka mbaruar shkollën e mesme si të shkollës së parë apo të dytë, që studion në universitet, që ndjek një master ose doktoraturë; kush ka ndjekur kurse të gjuhës italiane në Qendrat Territoriale të Përhershme dhe është në zotërim të njohjes së gjuhës italiane (niveli A2 ose më e lartë) ligjëruesit e universitetit, profesorë universitar, gazetarë dhe përkthyes të akredituar zyrtarisht.

Si mund të bëhet kërkesa?

Vetëm online nëpërmjet shërbimit informatik nga siti i Ministrisë së Brendshme: <http://testitaliano.interno.it>

Ku do të bëhet testi?

Prefektura, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, dërgon një njoftim ku tregohet ora dhe vendi ku do të kryhet testimi i gjuhës italiane. Personat që rezultojnë të papranishëm dhe nuk justifikojnë këtë mungesë ose nuk kalojnë testin, duhet të presin 90 ditë përpara se të riprezantojnë kërkesën.

Për informacione të mëtejshme

www.immigrazione.regione.toscana.it > Area tematica > Test di italiano per permesso di soggiorno UE per soggiornanti di lungo periodo (Testi i italishtes për lejen e qëndrimit afatgjatë KE për banuesit afatgjatë)

SPORTELI I VETËM PËR IMIGRIM

Ndodhet në çdo Prefekturë dhe merret me procedurat e mëposhtme:

- Bashkim familjar
- Hyrja në Itali për punë
- Kthimi i lejes së qëndrimit nga studio në punë
- Marrëveshja për Integrim
- Test i gjuhës italiane

Kërkesat mund të prezantohen sipas mënyrave të mëposhtme:

- **Me Internet:** Shërbimi i aplikimeve në mënyrë telematike në Ministrinë e Brendshme: www.interno.it > Immigrazione > Sportello Unico per l'Immigrazione
- **Sportelet Imigracioni:** (shiko në fund të faqes tek "Kontaktet")

Kontaktet

Sporteli i vetëm për Imigrim

Ruga Antonio Giacomini, 8 - 50132 Firenze (FI)
Telefon: 055 2783643 - e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte nga ora 9 deri në 12.00
e-mail: immigrazione.pref_firenze@interno.it
posta e çertifikuar: immigrazione.preffi@pec.interno.it

Kuestura

Ruga della Fortezza, 17 - 50129 Firenze (FI)
e-mail: immig.quest.fi@pecps.poliziadistato.it
posta e çertifikuar: immig.quest.fi@pecps.poliziadistato.it

Sportelet imigracioni

Për plotësimin dhe dërgimin e kërkesave nëpërmjet shërbimit informatik nga siti i Ministrisë së Brendshme është e mundur që të ndihmoheni nga Shërbimi i imigracionit komunal, sindakata apo shoqata.

Në faqen e internetit të PAeSI është e disponueshme lista www.immigrazione.regione.toscana.it > "Punti informativi per cittadini stranieri" (Pika informacioni për qytetarët e huaj)

Lidhje të rëndësishme

www.interno.gov.it
www.prefettura.it/firenze
www.immigrazione.regione.toscana.it



Progetto cofinanziato da



Ministero dell'Interno
PREFETTURA
DI FIRENZE



MINISTERO
DELL'INTERNO

Fondo Europeo Integrazione per i cittadini dei Paesi terzi 2007-2013

Progetto InfoMedia Informazione e Mediazione

Progetto FEI n.106581 - 2013 - Azione 9 - UTG Capacity Building



SPORTELI I VETËM PER IMIGRIM

NULA OSTA PËR BASHKIM FAMILJAR

Kush mund ta kërkojë?

Kush banon në Itali, punon dhe ka një vendbanim, mund të paraqesë kërkesë për bashkim familjar.

Çfarë kushtesh duhet të plotësojë aplikanti/ja?

- **të ardhurat ekonomike:** të jetë e barabartë të paktën me shifrën vjetore të rrogës sociale, duke e shtuar atë me gjysmën e saj për çdo person të ribashkuar (për shëmbull: në 2015 janë të nevojshme 8.746,14 € për të bashkuar 1 familjar dhe 11.661,52 € për 2 familjar, etj..)
- **banesa:** në momentin e aplikimit duhet të tregohet disponibiliteti i një vendbanimi nëpërmjet kontratës së qerasë dhe certifikatës së përshtatshmërisë së banesës që lëshohet nga Komuna

Për cilët anëtarë të familjes që banojnë jashtë mund të aplikohet për bashkim?

- **bashkëshorti/ja** që nuk janë të ndarë ligjërisht dhe që kanë mbushur moshën 18 vjeç
- **fëmijët e mitur**, edhe të bashkëshortit/es, ose të lindur jashtë martese, të pa martuar (prindi tjetër duhet të japi pëlqimin e tij)
- **fëmijët në moshë madhore në ngarkim**, vetëm nëse nuk arrijnë të vetëmbahen për shkak të arsyeve të rënda shëndetsore (paaftësi totale)
- **prindër në ngarkim:**
 - **deri në moshën 65 vjeç:** nëse nuk kanë fëmijë të tjerë në vëndin e lindjes ose të prejardhjes dhe janë plotësisht në ngarkim të fëmijës në Itali (nuk duhet të kenë të ardhura të tyre)
 - **mbi moshën 65 vjeç:** nëse fëmijët e tjerë nuk kanë mundësi për ti mbajtur për shkak të arsyeve të rënda shëndetsore, që vërtetohet nga Ambasada Italiane në vënd

Çfarë duhet bërë pasi familjari ka hyrë në Itali?

Brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali kontaktohet Sporteli i vetëm për Imigrim për të planifikuar një takim për të kërkuar lejen e qëndrimit për familjarin e sapoardhur

Çfarë duhet bërë pas takimit në Sportelin e vetëm për Imigrim?

Shko tek zyrat e mëposhtme:

- **Posta italiane:** të postojë kërkesën e re të lejes së qëndrimit
- **Komunën e banimit:** për tu regjistruar në gjendjen civile
- **Azienda ASL:** të kërkojë rregjistrimin në Shërbimin Kombëtar Shëndetsor
- **Në Kuesturë:** të paraqitet ditën e takimit për shenjat e gishtërinjve dhe më pas për tërheqjen e lejes së qëndrimit.

Për informacione të mëtejshme

www.immigrazione.regione.toscana.it > Area tematica > Ricongiun-gimento familiare (Bashkim familjar)

HYRJA NË ITALI PËR PUNË

Si bëhet?

Është e nevojshme të merret një vizë për punë. Për të patur vizën duhet të jetë një punëdhënës italian ose i huaj me leje qëndrimi të rregullt, që është i/e interesuar për të punësuar punëtorin/en e huaj që ndodhet jashtë vëndit.

Çfarë duhet të bëjë punëdhënësi?

duhet të presë “dekretin e fluksit”, i cili përcakton numrin maksimal të shtetasve të huaj jo komunitar, të pranuar çdo vit për të punuar në Itali

të kërkojë nula ostën për punë vetëm nëpërmjet shërbimit telematik nga siti i Ministrisë së Brendshme:

<https://nullaostalavoro.interno.it>

të presë për thirrjen nga Sporteli i vetëm për Imigrim në Prefekturë në mënyrë që të dorëzojë dokumentat dhe pastaj të tërheqë nula ostën për t’ia dërguar punëtorit që ndodhet jashtë vëndit

Çfarë duhet të bëjë punëtori?

pasi të ketë marrë nula ostën nga punëdhënësi: duhet të kërkojë vizë në Ambasadë ose Konsullatën italiane që ndodhet në vënd **brënda 8 ditëve nga hyrja në Itali:** duhet të kontaktojë Sportelin e vetëm për Imigrim që të caktojë takimin për të kërkuar lejen e qëndrimit.

Çfarë duhet të bëjë punëtori pas takimit në Sportelin e vetëm për Imigrim?

Duhet të shkojë në këto zyra:

- **Posta italiane:** të postojë kërkesën e re të lejes së qëndrimit
- **Komunën e banimit:** për tu regjistruar në gjendjen civile
- **Azienda ASL:** të kërkojë rregjistrimin në Shërbimin Kombëtar Shëndetsor
- **Në Kuesturë:** të paraqitet ditën e takimit për shenjat e gishtërinjve dhe më pas për tërheqjen e lejes së qëndrimit.

Për informacione të mëtejshme

www.immigrazione.regione.toscana.it > Area tematica > Lavoro Subordinato (Punësimi)

KTHIM I LEJES SË QËNDRIMIT NGA STUDIO NË PUNË OSE VETËPUNËSIM

Kush mund të bëjë kthim të lejes së qëndrimit nga studio në punë?

Kush është në mbajtje të lejes së qëndrimit për studio të vlefshme dhe ka një punëdhënës që është i interesuar për ta punësuar ose ka si qëllim të vetëpunësohet.

Si mund bëhet?

Duhet prituri “dekreti i fluksit” i cili përcakton numrin maksimal të personave të huaj jo komunitar të pranuar për të kthyer lejen e qëndrimit nga studio në punë

Vini re: nëse studenti ka mbushur 18 vjeç në Itali ose ka marrë një diplomë apo një titull studimi mbas universitar në Itali, kthimi i lejes së qëndrimit mund të bëhet **në çdo moment të vitit**

Çfarë duhet të bëjë studenti?

- Të kërkojë kthimin e lejes së qëndrimit nga studio në punë vetëm nëpërmjet shërbimit telematik nga siti i Ministrisë së Brendshme: <https://nullaostalavoro.interno.it>
- Të presë dhe më pas të paraqitet tek Sporteli i vetëm për Imigrim në Prefekturë për të dorëzuar të gjitha dokumentat dhe të tërheqi autorizimin e kthimit të lejes së qëndrimit

Çfarë duhet të bëjë studenti pasi ka vajtur në Sportelin e vetëm për Imigrim?

Të shkojë në zyrat e mëposhtme:

- **Posta italiane:** të postojë kërkesën e re të lejes së qëndrimit
- **Komunën e banimit:** për tu regjistruar në gjendjen civile
- **Azienda ASL:** të kërkojë rregjistrimin në Shërbimin Kombëtar Shëndetsor
- **Në Kuesturë:** të paraqitet ditën e takimit për shenjat e gishtërinjve dhe më pas për tërheqjen e lejes së qëndrimit.

Për informacione të mëtejshme

www.immigrazione.regione.toscana.it > Area tematica > Studio (Studim)